



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

Raport për rezultatet e konsultimit publik

për projektvendimin:

“Për miratimin e kriterëve në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në mjedis.

1. Titulli i projekt aktit

Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në mjedis”.

Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e kriterëve në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të menjëhershëm për dëm në mjedis dhe përcaktimi i dëmit në mjedis, me qëllim zbatimin e masave parandaluese dhe rehabilituese, në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

Gjithashtu, ky projektvendim garanton një qasje të unifikuar në vlerësimin e rasteve të kërcënimit të menjëhershëm dhe të dëmit mjedisor nga strukturat përgjegjëse në fushën e mjedisit, si dhe krijon bazën për ndërmarrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese, për përcaktimin e lidhjes shkakësore me veprimtarinë e operatorit dhe për ushtrimin e përgjegjësisë përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Projektvendimi synon:

- përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e ekzistencës së një kërcënimi të menjëhershëm për dëm mjedisor;
- përcaktimin e kriterëve për identifikimin dhe vlerësimin e dëmit mjedisor ndaj llojeve të mbrojtura dhe habitateve natyrore, ujërave dhe tokës;
- forcimin e përgjegjësisë së operatorëve, përmes krijimit të një kuadri të qartë për vlerësimin e lidhjes shkakësore ndërmjet veprimtarisë profesionale dhe dëmit në mjedis ose kërcënimit të menjëhershëm për një dëm të tillë;

- lehtësimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor, veçanërisht në kuadër të përgjegjësisë për dëmin mjedisor dhe masave parandaluese e rehabilituese;
- sigurimin e një kuadri të qartë ligjor dhe nënligjor për autoritetet kompetente në fushën e mjedisit, për vlerësimin, dokumentimin dhe arsyetimin e vendimmarrjes administrative në rastet e dëmit mjedisor ose të kërcënimit të menjëhershëm për një dëm të tillë;
- standardizimin e informacionit dhe të elementeve që duhet të merren në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit, përfshirë të dhënat teknike, laboratorike, të monitorimit dhe të gjendjes së mëparshme të burimeve natyrore dhe shërbimeve të tyre;
- mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në proceset e shqyrtimit të kërkesave, konsultimit të palëve, marrjes së masave përkatëse dhe bashkëpunimit ndërkufitar në rastet kur dëmi prek ose mund të prekë territorin e një shteti tjetër;
- harmonizimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian në fushën e përgjegjësisë mjedisore.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në mjedis” i është nënshtruar procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP), nga data 4.6.2026 deri në datë 2.7.2026. Numri i shikimeve në RENJK ishte 261.

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të projektvendimit, ishin:

1. Publikimi në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP),
2. Dëgjese publike në ambientet e Ministrisë së Mjedisit në datën 12.6.2026, ora 12:00.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe i është përcjellë për mendim, nëpërmjet sistemit e-akte: Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.

Në procesin e konsultimit është përfshirë Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri – FIAA, nëpërmjet dhënies së disa komenteve.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Në total janë paraqitur 8 komente/sugjerime, nga të cilat 3 (tre) janë pranuar dhe janë reflektuar në projektvendim, ndërsa 5 (pesë) janë refuzuar.

Refuzimi i tyre ka ndodhur për shkak se këto komente nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin dhe fushën e rregullimit të projektvendimit dhe, për rrjedhojë, nuk janë reflektuar në përmbajtjen e tij.

Komentet dhe vendimmarrja për secilin prej tyre, paraqiten më poshtë:

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/ I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Hartimi i projektvendimit “Për miratimin e kriterëve në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në mjedis” PIKA 2. Vlerësimi i kërcënimit të menjëhershëm për dëm në mjedis kryhet rast pas rasti, mbi bazën e informacionit më të mirë të disponueshëm, të dhënave	Duhet të përcaktohet se gjatë vlerësimit të kërcënimit të menjëhershëm në mjedis duhet të merren në konsiderat masat parandaluese ekzistuese të operatorit, si sistemet e menaxhimit mjedisor, procedurat e emergjencës, planet e reagimit ndaj incidenteve, sistemet e monitorimit dhe masat paraprake të marra nga subjekti.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Pranuar	Eshtë marre parasysh sugjerimi duke modifikuar pikën 3 ë të projektvendimit si më poshtë: ë) masat e marra ose të propozuara nga operatori për parandalimin, kufizimin ose kontrollin e dëmit, përfshirë sistemet e menaxhimit mjedisor, procedurat e emergjencës, planet e reagimit ndaj incidenteve, sistemet e monitorimit, masat e sigurisë dhe çdo masë tjetër

teknike, inspektimeve në terren, analizave laboratorike, të dhënave të monitorimit dhe çdo informacioni tjetër të nevojshëm. Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjatë procesit të vlerësimit, përcakton të paktën:				parandaluese, e zbatuar për reduktimin e rrezikut të dëmit mjedisor.
PIKA 3. Për qëllime të vlerësimit, merren në konsideratë:	Të shtohen kritere dhe limite sa më objektive dhe të matshme për përcaktimin e “kërcënimit të menjehershëm” me qëllim shmangien e subjektivitetit gjatë procesit të verifikimit.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Refuzuar	Projektvendimi parashikon një sërë kriteresh objektive për vlerësimin e kërcënimit të menjehershëm për dëm mjedisor, si natyra, sasia dhe rrezikshmëria e substancave, probabiliteti i ndodhjes së dëmit, afërsia me burime natyrore të ndjeshme, rrugët e përhapjes së

				ndotjes, gjendja teknike e instalimeve dhe rreziku për shëndetin e njeriut. Vlerësimi kryhet mbi bazën e të dhënave teknike, analizave laboratorike, monitorimit mjedisor dhe informacioneve të tjera të verifikueshme. Megjithatë, përcaktimi i kërcënimit të menjëhershëm kërkon vlerësim rast pas rasti dhe nuk mund të mbështetet vetëm në pragje fikse ose limite numerike, për shkak të natyrës së larmishme të veprimtarive dhe faktorëve mjedisorë që mund të përfshihen.
--	--	--	--	--

Shkronjat:	Koment: Duhet te jete percaktuese se gjate vleresimit te kercenimit apo demit mjedisor duhet te merret ne konsiderate zbatueshmeria/perpuths hmeria e operatorit me kushtet e lejes mjedisore, per kercenimin qe po vlerësohet.	Shoqata e Investitorë ve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Refuzuar	Respektimi i kushteve të lejes nuk përjashton automatikisht ekzistencën e një kërcënimi të menjëhershëm ose të një dëmi mjedisor, të cilët vlerësohen mbi bazën e rrethanave konkrete, të dhënave teknike dhe ndikimit real ose të mundshëm mbi mjedisin, për këtë arsye nuk mund të bëhet përcaktuese. Ndërkohë që në listë ka dhe aktivitete që nuk pajisen me leje mjedisi.
ç) lejet, autorizimet, raportet e vetëmonitorimit, raportet e inspektimit dhe të dhënat e shkarkimeve ose emetimeve;				
d) rezultatet e analizave laboratorike, matjeve në terren dhe të monitorimit mjedisor;				
dh) të dhënat mbi gjendjen e mëparshme të burimeve natyrore dhe të shërbimeve të tyre;				
e) informacioni n mbi llojet e mbrojtura, habitatet natyrore, ujërat, tokën dhe zonat e ndjeshme që				

mund të preken;				
Pika 4, shkronja d) rezultatet e monitorimit, analizave laboratorike, modelimeve teknike ose vlerësimeve të ekspertëve;	Te percaktohet se lidhja shakakesore duhet te mbeshtetet ne prova teknike, laboratorike ose shkencore te mjaftueshme.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Pranuar	Eshtë marrë parasysh sugjerimi duke modifikuar pikën 4 d) të projektvendimit si më poshtë: d) rezultatet e monitorimit, analizave laboratorike, modelimeve teknike ose vlerësimeve të ekspertëve, provave teknike dhe shkencore të mjaftueshme.
III. KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E DËMIT MJEDISOR Pika 5. Për dëmtimin e ujërave, vlerësimi kryhet duke marrë	Për vlerësimin e dëmtimit ndaj ujërave të merret në konsideratë perputhshmëria e operatorit me kushtet e lejes mjedisore dhe kufijtë e shkarkimit të miratuar nga autoritetet.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Refuzuar	Përputhshmëria me kushtet e lejes nuk përjashton automatikisht ekzistencën e një dëmi mjedisor, pasi vlerësimi i dëmit kryhet në bazë të ndikimit real ose të mundshëm mbi statusin ekologjik,

parasysh ndikimin e dëmit në statusin ekologjik, kimik ose sasior, potencialin ekologjik të ujërave, si dhe në gjendjen mjedisore të ujërave detare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për burimet ujore dhe mbrojtjen e mjedisit detar.				kimik ose sasior të ujërave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës.
Shtojca 2 - Gjendja e mëparshme e burimeve natyrore dhe e shërbimeve të tyre - Të dhënat teknike/laboratorike	Të bazohet në standartet ligjore dhe objektivat/raportet mjedisore të dokumentuara dhe të përcaktuara në legjislacion.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Pranuar	Ok. Do shtohen tek shtojca 2 e projektvendimit
	Te përcaktohen të dhënat laboratorike, në rastin e ujërave, në piken	Shoqata e Investitorëve të Huaj	Refuzuar	

	e shkarkimit te trupit uxor dhe ne piken e shkarkimit te operatorit.	në Shqipëri - FIAA		Nuk është objekt i këtij vendimi.
Afatet për zbatimin e masave, kur përcaktohen	Afatet kohore për zbatimin e masave duhet të jenë të qartesuara sipas kategorizimit te riskut.	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri - FIAA	Refuzuar	Projektvendimi parashikon që afatet për zbatimin e masave të përcaktohen nga autoriteti përgjegjës, në varësi të rrethanave konkrete të rastit dhe karakteristikave të dëmit ose kërcënimit të identifikuar. Nuk mund të përcaktohen afatet kohore në këtë VKM, sepse dhe masat e marra janë aq të ndryshme nga njëra tjetra. Kjo bëhet rast pas rasti në bazë të dëmit, aktivitetit dhe zonës ku ndodh dëmi.